

RELACION SHPJEGUES

I PROJEKTLIGJIT “PËR PADITË KOLEKTIVE”

I. Qëllimi i projektligjit dhe objektivat që synohet të arrihen.

Në kontrast me sistemet juridike të disa prej vendeve anëtare të BE-së, në vendin tonë vërehet mungesa e mjeteve juridike që sigurojnë mbrojtjen kolektive të konsumatorëve apo dhe të grupeve të tjera në nivel gjyqësor, përfshirë këtu instrumentin e dëmshpërblimit kolektiv. Kjo mungesë është bërë pengesë për trajtimin kolektiv të shkeljeve të kryera nga ndërmarrjet të cilat janë në pozita të favorshme dhe shpesh mbeten të paprekura nga pretendimet mbi shkeljet që ato kryejnë në dëm të individëve të një grupi të caktuar. Trajtimi individual i shkeljeve nuk ka pasur ndonjë efekt, për të mos thënë që çdo përpjekje individuale ka rezultuar e dështuar për shkak të pafuqisë që mbart individi përkundrejt ndërmarrjeve të cilat gëzojnë një mbështetje dhe mbrojtje me të madhe, falë burimeve financiare dhe logjistike, por dhe për shkak të pozitës së tyre në treg.

Shpesh kemi konstatuar praktika tregtare që dëmtojnë rëndë interesat e konsumatorëve. Këtu mund të përmendim shkeljet e evidentuara nga operatorë të industrisë bankare, të telekomunikacionit, të tregtisë dhe shërbimit në industrinë ushqimore dhe jo-ushqimore, shkelje të cilat janë prezente për sa kohë nuk luftohen pasi mungojnë instrumentet që mundësojnë pengimin e këtyre shkeljeve dhe për më tepër mungojnë mekanizmat për të kërkuar dëmshpërblim kolektiv.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i instrumentit ligjor të padisë kolektive, i cili do të lehtësonte aksesin në drejtësi, do të ndalonte dhe parandalonte sjelljen e paligjshme dhe do t'u mundësonte personave të dëmtuar të kompensohen në rastet e dëmeve kolektive për shkak të shkeljeve të të drejtave civile, të drejtave ekonomike dhe shkeljet në marrëdhëniet e punës. Nëpërmjet implementimit të këtij projektligji në sistemin juridik shqiptar, synohet krijimi i një mekanizmi procedural efektiv, për mbrojtjen në grup të interesave të grupeve të konsumatorëve, punëmarrësve apo grupeve të tjera me interesa të përbashkëta, për të cilët mbrojtja individuale nuk është efektive. Padia kolektive do të ketë një impakt pozitiv dhe në administrimin e drejtësisë, duke sjellë pasojë pozitive në ruajtjen e ekonomisë gjyqësore nëpërmjet evitimit të procedurave

gjyqësore individuale për shkak të përfshirjes së një numri të madh personash të dëmtuar në një procedurë kolektive të vetme.

II. Argumentimi i projektligjit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme.

Ky projektligj propozon krijimin e një mjeti procedural të ri, atë të padisë kolektive, i cili nuk njihet nga Kodi i Procedurës Civile aktual. Sistemet juridike të cilat parashikojnë instrumentin e padisë kolektive, kanë zgjedhur mënyra të ndryshme në lidhje me formën e implementimit të këtij instrumenti në korpusin e së drejtës së tyre. Disa prej këtyre sistemeve kanë zgjedhur që ta parashikojnë këtë mjet procedural, në tërësinë e tij, në Kodin e Procedurës Civile, ndërkohë disa të tjerë kanë miratuar një ligj të posaçëm që rregullon të gjitha aspektet e një padie dhe procedure kolektive.

Duke vlerësuar kuadrin ligjor procedural në Shqipëri, është menduar më e përshtatshme miratimi i një ligji të veçantë për paditë kolektive, sesa implementimi i këtyre dispozitave në Kodin e Procedurës Civile. Së pari, duke qenë se padia kolektive është një instrument i ri në sistemin juridik shqiptar, mund të ndodhë që dispozitat që rregullojnë padinë kolektive të kenë nevojë të rishikohen me vënien e tyre në zbatim, për shkak të problematikave praktike që mund të lindin nga zbatimi i tyre dhe që nuk mund të parashikohen në fazën e miratimit të tij. Duke qenë se ndryshimi i një ligji kërkon një shumicë të thjeshtë në parlament në krahasim me ndryshimin e një Kodi, rregullimi i padisë kolektive me një ligj të veçantë shihet si mjeti i duhur ligjvënës në këtë drejtim, pasi do të facilizojë procesin legjislativ të rishikimit të dispozitave mbi padinë kolektive, nëse do të jetë e nevojshme. Së dyti, dispozitat procedurale në lidhje me padinë kolektive, pavarësisht se janë në harmoni me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, krijojnë një procedurë tërësisht të re. Për këtë shkak, implementimi i tyre në Kod do të ishte konfundues dhe do të mbingarkonte Kodin me norma të tjera, të cilat nuk kanë lidhje të domosdoshme me njëra-tjetrën.

Padia kolektive mund të ngrihet nga disa anëtarë të një grupi të dëmtuar, nga një përfaqësues i tyre ose nga Prokurori. Në lidhje me mënyrën sesi individët e një grupi të dëmtuar do të përfshihen në një padi kolektive, projektligji ka parashikuar si mënyra alternative mekanizmin e përfshirjes dhe mekanizmin e përjashtimit. Sipas mekanizmit të përfshirjes, vetëm individët që shprehin interes gjatë një procedure kolektive, duke paraqitur dokumentacionin provues përkatës, konsiderohen pjesëmarrës të kësaj procedure. Në këtë rast, vendimi mbi padinë kolektive do të prodhojë pasoja

vetëm mbi individët të cilët janë përfshirë në procedurën kolektive, sipas rregullave të detajuara që përcaktohen në ligj. Nga ana tjetër, projektligji ka parashikuar dhe mekanizmin e përjashtimit, sipas së cilit të gjithë anëtarët e një grupi të cilët kanë pësuar një dëm kolektiv, janë *a priori* pjesëmarrës në një procedurë kolektive të iniciuar, pavarësisht pasivitetit të tyre për përfshirjen në këtë procedurë. Në këtë rast, individët e një grupi të caktuar mund të përjashtohen nga pasojat e një vendimi mbi një padi kolektive, vetëm në rastet kur shprehimisht e kërkojnë këtë përpara gjykatës, në formën që ka përcaktuar projektligji. Të dyja këto mekanizma synojnë përfshirjen e sa më shumë individëve të një grupi të dëmtuar, të cilët kanë interes për të përfituar dëmshpërblim në rastin e një dëmi kolektiv.

Në lidhje me ushtrimin e të drejtave procedurale nga individët e grupeve të dëmtuara, në rastet kur është ngritur një padi kolektive, projektligji parashikon metoda efikase njoftimi, siç është njoftimi nëpërmjet përfaqësuesit të grupit, faqes së internetit të krijuar posaçërisht për padinë kolektive, si dhe komunikimit nëpërmjet mediave të tjera. Qëllimi i parashikimit të disa mënyrave të njoftimit ka qenë mbulimi sa më i madh duke pasur parasysh se numri i anëtarëve të një grupi mbetet shpesh i paidentifikuar, dhe njoftimi i tyre personalisht mund të jetë i pamundur. Mendohet se komunikimi nëpërmjet faqes së internetit apo mediave të tjera, është një mjet i përshtatshëm për të siguruar njoftimin e çdo individi që mund të ketë interes në lidhje me një padi kolektive.

Në mbështetje të informimit të publikut në lidhje me zhvillimin e një procedure kolektive, projektligji parashikon një mbajtjen e një regjistri publik të padive kolektive, në të cilin do të pasqyrohen të gjitha të dhënat në lidhje me një procedurë të filluar të padisë kolektive. Kjo do të shpërbejë jo vetëm për të informuar çdo person që mund të ketë interes të ligjshëm në lidhje me një procedurë kolektive, por do të evitojë dhe ngritjen e disa padive kolektive për të njëjtin dëm kolektiv, veprim i cili ndalohet nga dispozitat e projektligjit.

Projektligji i jep një vemendje të veçantë mënyrës së përfaqësimit të grupeve të cilat kanë pësuar një dëm kolektiv, duke parashikuar mekanizma efektive që ky përfaqësim të jetë i përshtatshëm dhe në dobi të grupit. Në projektligj parashikohet se përfaqësues të një grupi mund të jenë OJF të cilat kanë për objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave që mund t'i jenë cënuar një grupi të caktuar. Kjo mendohet stimulojë përdorimin e instrumentit të padisë kolektive, duke qenë se OJF-të mund të jenë më të prirura për tu investuar në ngritjen e kësaj padie, në krahasim me grupe individësh të dëmtuar nga një shkelje e caktuar.

Përveç padisë kolektive, projektligji parashikon mundësinë që një mosmarrëveshje në lidhje me një dëm kolektiv, të zgjidhet me marrëveshje, nëpërmjet mekanizmit të quajtur “zgjidhje kolektive”. Zgjidhja kolektive është një marrëveshje e përbashkët midis grupit të dëmtuar dhe ndërmarrjes që ka shkaktuar dëmin kolektiv, që rregullon mënyrën sesi do të dëmshpërblehet grupi i dëmtuar nga ndërmarrja, masa e dëmshpërblimit dhe personat që do të përfitojnë. Parashikimi i zgjidhjes kolektive si mjet ligjor për të zgjidhur një mosmarrëveshje kolektive, do të minimizojë procedurat e gjata që kërkon shqyrtimi i një padie kolektive, duke dhënë një zgjidhje më të shpejtë të mosmarrëveshjes.

Një risi tjetër që projektligji ka qenë është përfshirja e noterit publik në procedurën e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Me qëllim administrimin e procesit të përfitimit të masave të dëmshpërblimit nga anëtarët e grupit të dëmtuar, është parashikuar se masa tërësore e dëmshpërblimit të dhënë nga gjykata t’i kalohet noterit në një llogari të posaçme. Më pas, noteri bën shpërndarjen e masave të dëmshpërblimit tek secili anëtar i grupit që legjitimohet për të përfituar dëmshpërblim, sipas kërkesave të parashikuara në projektligj.

Pavarësisht se projektligji parashikon për gjykimin e një padie kolektive një procedurë më të ndërlikuar se procedura normale e një padie civile, ai eviton gjykimin e shumë padive individuale për të njëjtin rast të dëmit kolektiv. Në këtë pikëpamje, miratimi i këtij projektligji është një avantazh në administrimin e drejtësisë dhe ekonominë gjyqësore.

III. Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi vendas e ndërkombëtar.

Projektligji i propozuar është në përputhje me rendin juridik të brendshëm.

IV. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me *acquis communautaire*

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar. Megjithatë, Këshilli i BE-së pritet të propozojë për miratimin një direktivë, nëpërmjet së cilës do të implementohet në *acquis communautaire* instrumenti i padisë kolektive. Me miratimin e kësaj direktive, të gjitha vendet anëtare të BE-së, si dhe vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e BE-së, duhet të transpozojnë përmbajtjen e kësaj direktive në legjislacionin e tyre të brendshëm.

V. Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektligjit

Në Kreun I të projektligjit janë parashikuar dispozita të përgjithshme, në të cilat përfshihen qëllimi i projektligjit, përkufizime të termave të përdorur në përmbajtjen e tij, personat që legjitimohen për të ngritur një padi kolektive, mënyra e zgjedhjes së përfaqësuesit të grupit të dëmtuar, si dhe krijimin e një regjistri publik për pasqyrimin e padive kolektive.

Në Nenin 1 dhe 2 të projektligjit është përcaktuar qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së tij. Neni 2 ka përcaktuar se projektligji parashikohet të zbatohet vetëm në lidhje me pretendimet për cënimin e të drejtave të konsumatorëve, të rregullave për mbrojtjen e konkurrencës, ndalimin e diskriminimit dhe për mosmarrëveshjet kolektive të punës.

Në Nenin 3 të projektligjit janë dhënë përkufizimet e termave të përdorur në përmbajtjen e tij. Në këto përkufizime, vihet re krijimi i instrumenteve të reja procedurale, siç janë padia kolektive, vendimi kolektiv, zgjidhja kolektive apo masa kolektive. Konkretisht, padia kolektive konsiderohet padia civile e ngritur nga një grup i dëmtuar nga një dëm kolektiv, për pretendime që bien brenda fushës së veprimtarisë së përcaktuar nga Neni 2 i projektligjit. Zgjidhja kolektive është marrëveshja dy-palëshe midis grupit të dëmtuar dhe ndërmarrjes që ka shkaktuar dëmin kolektiv, e cila rregullon marrëdhënien midis tyre në lidhje me pasojat e këti dëmi, dhe që miratohet nga gjykata. Vendimi kolektiv është vendimi përfundimtar i gjykatës që zgjidh në themel një padi kolektive të paraqitur, ose që disponon mbi kërkesën për miratimin e një zgjidhje kolektive. Masa kolektive është një masë sigurimi që gjykata e jep me kërkesë të personave të interesuar, nëpërmjet së cilës synohet ndalimi i sjelljes që ka shkaktuar ose pritet të shkaktojë një dëm kolektiv, derisa gjykata të shprehet me vendim përfundimtar mbi themelin e një padie kolektive.

Në Nenin 4 janë përcaktuar personat që legjitimohen për ngritjen e një padie kolektive. Sipas kësaj dispozite, padia kolektive mund të ngrihet nga më shumë se një person i dëmtuar nga një dëm kolektiv. Kjo dispozitë ka përcaktuar se për efekt të legjitimitit të një grupi të dëmtuar për të ngritur një padi kolektive, nevojiten të paktën dy persona. Duke parashikuar një dekurajim potencial të individëve të dëmtuar për tu bashkuar dhe për të investuar gjykatën në rastin e një dëmi kolektiv, për çfarëdo arsye, kjo dispozitë ka parashikuar mundësinë që padia kolektive të ngrihet dhe nga një OJF që vepron në fushën përkatëse ku është shkaktuar dëmi kolektiv. Përfshirja e Prokurorit në listën e personave të legjitimuar për ngritjen e një padie kolektive ka pasur si qëllim

përfshirjen e një autoriteti publik, duke vlerësuar interesin publik që ka shqyrtimi dhe gjykimi i një padie kolektive.

Në Nenin 5, 6 dhe 7 janë përcaktuar rregullat e përgjithshme procedurale që do të zbatohen gjatë gjykimit të një padie kolektive ose kërkesë për miratimin e një zgjidhje kolektive. Si rregull, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile janë të zbatueshme për ato aspekte procedurale për të cilat ligji nuk bën një rregullim të posaçëm. Neni 6 rregullon parimin *lis-pendens*, për të evituar shqyrtimin e së njëjtës padi kolektive, për sa i përket palëve, objektit dhe shkakut ligjor. Si rregull, një padi kolektive mund të gjykohet vetëm një herë. Në lidhje me paditë individuale të ngritura për të njëjtin dëm kolektiv, në rastin kur ngrihet një padi kolektive, gjykimi për paditë individuale do të pezullohet derisa të zgjidhet me vendim të formës së prerë padia kolektive e ngritur. Kjo zgjidhje është vendosur për të evituar që të njëjtët individë që përfitojnë nga një padi kolektive, të përfitojnë dhe nga padia individuale e ngritur për të njëjtin shkak. Në këtë rast, padia individuale do të pushohet. Në rastet kur rrëzohet padia kolektive, gjykimi i padisë individuale vazhdon dhe vendimi i padisë kolektive nuk është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton padinë individuale. Kjo për shkak se rrethanat e faktit në padinë individuale mund të jenë të ndryshme nga ato që lidhen me padinë kolektive. Neni 7 parashikon që afatet e parashkrimit për efekt të padisë kolektive do të jenë ato të parashikuara si të tilla në Kodin Civil.

Neni 8 ka referuar shprehimisht rastet e padive kolektive të cilat lidhen me cënimin e konkurrencës. Në këto raste, padia kolektive mund të ngrihet vetëm nëse ka një vendim përfundimtar të Komisionit të Konkurrencës për konstatimin e cënimit të konkurrencës sipas ligjit të posaçëm.

Nën Nenin 9 është parashikuar mbajtja e një regjistri publik të padive kolektive, i cili ka për funksion informimin e publikut në lidhje me paditë kolektive të cilat janë në gjykim ose të cilat janë gjykuar. Kjo do të mundësojë që të gjithë individët të cilët vlerësojnë se janë cënuar nga një dëm kolektiv, të informohen dhe të përfshihen në një padi kolektive, sipas mënyrave që parashikon projektligji. Gjithashtu, ky regjistër do të evitojë gjykimin e një padie kolektive më shumë se një herë, në përputhje me kërkesat e Nenit 6 të projektligjit. KLGJ do të jetë institucioni që do të përcaktojë autoritetin dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit publik për paditë kolektive. Është menduar që ky regjistër të jetë unik për të gjithë sistemin gjyqësor, me qëllim për të lehtësuar aksesin dhe për të përqëndruar informacionin mbi paditë kolektive në një hapësirë unike.

Kreu II përmban dispozita që rregullojnë procedurën e miratimit të një kërkesë për zgjidhje kolektive. Zgjidhja kolektive është një marrëveshje midis grupit të dëmtuar dhe personit që ka shkaktuar dëmin kolektiv, për ta zgjidhur mosmarrëveshjen që lidhet me dëmin kolektiv me pajtim. Sipas Nenit 10, zgjidhja kolektive miratohet nga gjykata me kërkesën e përbashkët të përfaqësuesit të grupit të dëmtuar ose vetë ky grup dhe personi që ka shkaktuar dëmin kolektiv. Neni 11 përcakton përmbajtjen që duhet të ketë një zgjidhje kolektive në mënyrë që ajo të miratohet nga gjykata.

Shqyrtimi i një kërkesë për miratimin e një zgjidhje kolektive është menduar të kalojë dy faza gjykimi. Faza e parë lidhet me pranueshmërinë e kërkesës për gjykim, pasi gjykata të ketë vlerësuar se kërkesa përmban elementet formale thelbësore të nevojshme për gjykimin e saj. Neni 12 përcakton kriteret që zbatohen në rastin e pranueshmërisë së kërkesës për miratimin e një zgjidhje kolektive, vendimin që gjykata merr dhe procedurën e ankimit ndaj këtij vendimi. Në Nenin 13 është parashikuar mënyra e informimit të anëtarëve të grupit në rastin kur është pranuar për shqyrtim një kërkesë për miratimin e zgjidhjes kolektive. Në këtë fazë, njoftimi i anëtarëve të grupit shërben vetëm për t'i informuar ata në lidhje me pranimin e kërkesës për shqyrtim. Si rregull, ky njoftim duhet t'i dërgohet të gjithë anëtarëve të identifikuar të grupit, adresa e së cilëve është e përcaktuar. Në të kundërt, nëse kjo nuk është e mundur, njoftimi do të konsiderohet i ezauruar vetëm duke njoftuar përfaqësuesin e grupit të dëmtuar. Ky parashikim është bërë duke marrë parasysh faktin që njoftimi i të gjithë anëtarëve të grupit mund të jetë shumë i vështirë në praktikë.

Neni 14 parashikon se kërkesa për zgjidhje kolektive shqyrtohet nga gjykata në seancë gjyqësore me praninë e të dyja palëve. Neni 15 parashtron shkaqet për të cilat gjykata mund të vendosë rrëzimin e kërkesës. Paragrafi i dytë i këtij neni i jep mundësinë palëve që të rishikojnë kushtet e zgjidhjes kolektive, përpara se gjykata të vendosë rrëzimin e kërkesës për miratimin e saj. Neni 16 përcakton mekanizmin që mund të përdorin anëtarët e grupit për tu përfshirë në zgjidhje kolektive, në rastet kur ajo pranohet nga gjykata. Sipas paragrafit të tretë të këtij neni, në harkun kohor nga 30 ditë deri në 90 ditë pas publikimit të vendimit për pranimin e zgjidhjes kolektive në regjistrin e padive kolektive, anëtarët e grupit mund të paraqesin kërkesën e tyre për tu përfshirë ose për tu përjashtuar nga zgjidhja. Më pas gjykata miraton listën përfundimtare të personave që përfshihen në zgjidhje kolektive, në përputhje me parashikim e paragrafit të katërt të Nenit 16. Në Nenin 17

është parashikuar detyrimi i gjykatës për të njoftuar anëtarët e grupit për miratimin e një zgjidhje kolektive, në mënyrë që këto të fundit të kenë efektivisht mundësinë për të ushtruar të drejtën e përfshirjes ose të përjashtimit në zgjidhjen kolektive. Ky njoftim është plotësues i publikimit që bëhet në regjistrin e padive kolektive, duke qenë se mendohet që jo të gjithë personat anëtarë të një grupi do të konsultohen me regjistrin e padive kolektive, kohë pas kohe. Ky mekanizëm shtesë njoftimi është konsideruar si shterues për efekt të njoftimit të vendimit për miratimin e një zgjidhje kolektive.

Zgjidhja kolektive do të ketë efekt mbi të gjithë anëtarët e grupit të cilat kanë pranuar të jenë pjesë e kësaj zgjidhje sipas mekanizmave përkatës. Në Nenin 18 parashikohet se vendimi për miratimin e një zgjidhje kolektive përbën gjë të gjykuar për personat e përfshirë në zgjidhje për të njëjtin rast të dëmit kolektiv.

Bazuar në paragrafin e dytë të Nenit 19, anëtarët e një grupi të dëmtuar mund të tërhiqen nga zgjidhja kolektive në rastin kur dëmshpërblimi nuk paguhet në formën e përcaktuar në këtë zgjidhje. Në këtë rast, grupi mund të ngrejë një padi kolektive, duke referuar për gjykatën shkaqet e ngritjes së padisë të cilat lidhen me mosrespektimin e zgjidhjes.

Duke qenë se zgjidhja kolektive është një zgjidhje me pajtim e mosmarrëveshjes, në Nenin 20 është parashikuar që kompensimi mund t'i paguhet edhe një anëtar të grupit në emër të anëtarëve të tjerë, në rast se këto të fundit nuk kanë kundërshtime në lidhje me këtë. Në këtë rast, anëtarët e grupit shfaqen si kreditorë solidarë, të cilët më pas kanë detyrimin e kalimit të shumës përkatëse të kompensimit tek secili anëtar i grupit. Në Nenin 21 është rregulluar rasti kur kompensimi tërësor i përcaktuar në zgjidhjen kolektive nuk është i mjaftueshëm për të gjithë anëtarët e grupit. Në këto raste, shumën e kompensimit individual do të zbritet proporcionalisht. Në rastet kur nga kompensimi tërësor ka tepriçë edhe pasi janë kompensuar të gjithë anëtarët e grupit të përfshirë në zgjidhje kolektive, kjo tepriçë i kthehet personit që ka paguar kompensimin.

Në nenin 22 dhe 23 është parashikuar ankimi ndaj vendimit për refuzimin e kërkesës për zgjidhje kolektive, si dhe shpenzimet e procedurave. Duke qenë se zgjidhja kolektive miratohet me kërkesë të përbashkët të të dyja palëve, është menduar që ankimi të lejohet vetëm ndaj vendimit që refuzon këtë kërkesë. Për sa i përket shpenzimeve të procedurës, si rregull ato përcaktohen në zgjidhjen kolektive dhe nëse nuk ka një rregullim të tillë, ato ndahen në mënyrë të barabartë nga palët në proces.

Në Kreun III të projektligjit është rregulluar në mënyrë të detajuar procedura që ndiqet për depozitimin, shqyrtimin dhe ekzekutimin e një vendimi në lidhje me një padi kolektive. Në nenin 24 parashikohen elementet thelbësore që duhet të ketë padia kolektive në mënyrë që ajo të mos pranohet. Mungesa e njërit prej këtyre elemente e bën padinë kolektive me të meta. Në këtë rast, sipas nenit 25, gjykata i lë paditësve një afat jo më të gjatë se 10 ditë për plotësimin e të metave, përndryshe vendos kthimin e padisë pa veprime.

Përveç elementeve thelbësore që një padi kolektive duhet të përmbajë sipas nenit 24 të projektligjit, gjykata shqyrton edhe nëse padia kolektive mund të pranohet për gjykim në bazë të elementeve që përcaktohen në nenin 26. Në këtë drejtim, në mënyrë që padia kolektive të pranohet për shqyrtim, duhet që grupi i dëmtuar të jetë i identifikueshëm, përfaqësimi i grupit të jetë në përputhje me ligjin, padia kolektive të mos jetë haptazi e pabazuar dhe të jenë respektuar kushtet në lidhje me financimin e procedurave, për të cilat do të flasim më poshtë më në detaje. Sipas nenit 27 të projektligjit, pasi verifikon ekzistencën e elementeve formale dhe substanciale të përmendura më sipër, merr vendim për shqyrtimin në themel të padisë kolektive. Përmbajtja e këtij vendimi përcaktohet po në nenin 27, ku ndër të tjera veçojmë se mekanizmi i përfshirjes në padi kolektive dhe mënyra e njoftimit të anëtarëve të grupit duhet të identifikohet që në këtë vendim. Edhe pse mekanizmi i përfshirjes në një padi kolektive, përcaktohet që në padinë kolektive, ka raste kur gjykata duhet të vendosë për njërin ose tjetrin mekanizëm në mënyrë të detyrueshme, siç përcaktohet në nenin 28 të projektligjit.

Vendimi për shqyrtimin e padisë kolektive i njoftohet anëtarëve të grupit në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 29 të projektligjit, sipas së cilit zbatohet e njëjta mënyrë njoftimi si në rastin e zgjidhjes kolektive. Pra njoftimi nëpërmjet publikimit në regjistrin publik të padive kolektive, njoftimi i individual i anëtarëve të grupit, nëpërmjet përfaqësuesit ose nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të hapur posaçërisht nga paditësit për këtë qëllim. Duhet thënë se këto metoda njoftimi janë alternative dhe jo kumulative, duke pasur parasysh vështirësitë që mund të ketë në praktikë njoftimi i një numri të pacaktuar të një grupi të dëmtuar. Neni 30 përcakton dhe përmbajtjen që duhet të ketë njoftimi i grupit për pranimin për shqyrtim të një padie kolektive.

Neni 31 dhe 32 rregullon pozitën dhe procedurën e përfshirjes së anëtarëve të grupit në gjykimin e një padie kolektive, pasi ajo është pranuar për shqyrtim nga gjykata. Vlen të theksohet se përfshirja në procedurë sipas këtij neni, jo domosdoshmërisht i jep personave të përfshirë atributet

për të përfituar kompensim nga dëmi kolektiv. Kjo do të vlerësohet nga gjykata në përfundim të gjykimit, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e rrethanave të faktit dhe provave të administruara në gjykim. Neni 33 shërben si një garanci se përfaqësuesi i grupit të dëmtuar do të veprojë në përputhje me interesin më të lartë të grupit. Në rast se gjykata konstaton se përfaqësuesi nuk po vepron në interes të grupit, gjykata mund të zëvendësojë atë me një përfaqësues tjetër, nëse ka një të tillë të gatshëm për ta pranuar këtë detyrë. Në të kundërt, gjykata mund të vendosë dhe pezullimin e gjykimit derisa të gjendet një përfaqësues i përshtatshëm për grupin.

Në Nenin 34 është lënë një hapësirë sipas së cilës palët mund të arrijnë në një zgjidhje kolektive gjatë procedurës kolektive, zgjidhje e cila duhet të miratohet nga gjykata, sipas rregullave për shqyrtimin e një zgjidhje kolektive. Neni 35 i jep të drejtë anëtarëve të grupit të cilët janë përfshirë në procedurë sipas neneve 31 dhe 32 që të jenë pjesëmarrës aktiv në proces dhe të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim përpara gjykatës. Megjithatë, ata nuk kanë të drejtë të rimbursohen për shpenzimet individuale për përfshirjen në procedurë kolektive. Kjo është parashikuar e tillë, pasi nuk do të ishte e përshtatshme që paditësit të rimbursoheshin dhe për shpenzimet e përfaqësimit në grup dhe për ato individuale, përse kohë përfaqësimi individual është plotësues dhe jo detyrues.

Neni 36 përcakton elementet që duhet të përmbajë vendimi që pranon plotësisht ose pjesërisht një padi kolektive. Në Nenin 37 është parashikuar detyrimi i gjykatës për të bërë një vlerësim individual të dëmeve, në rastin kur anëtarët e grupit janë të identifikuar. Kjo është e mundur vetëm kur është zbatuar mekanizmi i përfshirjes, pasi sipas mekanizmit të përjashtimit të gjithë anëtarët e grupit konsiderohen të përfshirë përveç atyre që kanë kërkuar shprehimisht të përjashtohen nga efektet e padisë kolektive. Në rastet kur vlerësimi individual nuk është i mundur, bazuar në nenin 38 të projektligjit, gjykata do të përcaktojë vetëm masën tërësore të kompensimit për të gjithë grupin ose shumën në përqindje ose njësi që do të përfitojë secili anëtar i grupit.

Neni 39 në mënyrë të shprehur ka parashikuar se vendimi mbi një padi kolektive ka efekt vetëm për personat që kanë bërë një deklaratë përfshirje, në rastin kur është zbatuar mekanizmi i përfshirjes. Ndërsa në rastin kur procedura kolektive është udhëhequr sipas mekanizmit të përjashtimit, vendimi do të ketë efekt mbi të gjithë anëtarët e grupit, përveç atyre që kanë bërë një deklaratë përjashtimi.

Në rastin kur është marrë një vendim për pranimin e padisë kolektive, duhet domosdoshmërisht të njoftohen anëtarët e grupit, në mënyrë që të fillojnë me procedurën e ekzekutimit dhe të përfitimit të masave të kompensimit përkatëse. Duhet saktësuar se në rastin e mekanizmit të përfshirjes, ekzekutimi është më i lehtë, pasi anëtarët e grupit identifikohen. Ndërsa në rastin e mekanizmit të përjashtimit, është e nevojshme një procedurë shtesë, sipas së cilës do të përpilohet një listë e personave të cilët kanë kërkuar efektimisht dëmshpërblim. Më poshtë do të shpjegojmë sesi është rregulluar kjo procedurë nga ligji.

Në Nenin 40 është parashikuar detyrimi i njoftimit të vendimit mbi padinë kolektive, në mënyrë që anëtarët e grupit të mund të marrin dijeni se kanë të drejtë të përfitojnë një dëmshpërblim.

Neni 41 ka parashikuar se gjykata emëron një noter për administrimin e procedurës së shpërndarjes së dëmshpërblimit. Mënyra dhe procedura që ndjek noteri për administrimin e shumës së dëmshpërblimit është e përcaktuar në dispozitat vijuese të projektligjit.

Sipas Nenit 42, në rastin e mekanizmit të përfshirjes, noteri evidenton personat e përfshirë në vendimin kolektiv dhe pret kërkesat e tyre për përfitimin e masës individuale të dëmshpërblimit. Ky veprim bëhet brenda 30 ditëve nga caktimi i noterit, i cili në përfundim të këtij afati është i detyruar që të kalojë dëmshpërblimin individual për çdo person që ka paraqitur një kërkesë të tillë.

Në rastin e mekanizmit të përfshirjes, sipas paragrafit të dytë dhe të tretë të Nenit 42, noteri pret kërkesa nga të gjithë personat që e konsiderojnë veten anëtarë të grupit. Në këtë rast, kërkuarit duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës për të vërtetuar se janë anëtarë të grupit. Kërkesa në këtë rast, mund të ushtrohet sipas afateve që ka përcaktuar gjykata për tu përfshirë ose përjashtuar në të drejtën për të përfituar dëmshpërblim. Në përfundim të këtij afati, noteri harton listën përfundimtare të personave që kanë paraqitur kërkesë për dëmshpërblim, e cila duhet të miratohet nga gjykata.

Lista i njoftohet edhe palëve në proces, të cilat duhet të paraqesin kundërshtimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e saj brenda 15 ditëve nga njoftimi i kësaj liste. Më pas, gjykata merr vendim përfundimtar mbi listën e personave që do të përfitojnë dëmshpërblim. Për të mos e tejzgatur këtë procedurë, është parashikuar që kundër këtij vendimi të mos lejohet ankim.

Në Nenin 44 është parashikuar se pas dhënies së vendimit të formës së prerë të gjykatës, noteri kryen veprimet e nevojshme për kalimin e shumave individuale sipas listave përfundimtare të

personave të përfshirë për të përfituar dëmshpërblim. Në përfundim të këtij procesi, noteri harton një raport përfundimtar të veprimeve që ka kryer dhe e depoziton në gjykatë.

Në Kreun IV janë përcaktuar dispozita të cilat rregullojnë masat e sigurimit të cilat lidhen me një dëm kolektiv i cili po shkaktohet ose pritet të shkaktohet nga ndonjë ndërmarrje e caktuar.

Në Seksionin I të këtij kreu parashikohen dispozita të përgjithshme në lidhje me masat kolektive në përgjithësi. Sipas Nenit 45 të projektligjit, nëse Gjykata konstaton se sjellja e personit që ka shkaktuar dëm vazhdon të jetë e tillë, mund të urdhërojë menjëherë në formën e një masë kolektive, edhe pse ende nuk janë të identifikuar anëtarët e grupit të prekur, ndalimin e sjelljeve të cilat mund ti shkaktojnë dëme te metejshme grupit. Neni 46 përcakton përmbajtjen që duhet të ketë vendimi që pranon masën kolektive. Në Nenin 47 është parashikuar se kundër vendimit mbi kërkesën për vendosjen e një masë kolektive mund të bëhet ankim i veçantë sipas rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile në lidhje me masat e sigurimit në përgjithësi.

Në Seksionin II të këtij kreu përcaktohen dispozita të posaçme në lidhje me masat kolektive për mbrojtjen e konsumatorëve. Në Nenin 48 dhe 49 të projektligjit parashikohet që kërkesa për masë kolektive mund t'i kundërdrejtohet çdo personi që po shkakton ose pritet të shkaktojë një dëm kolektiv, qoftë kjo një ndërmarrje ose grup ndërmarrjesh që veprojnë në të njëjtin sektor të ekonomisë, dhomë tregtise ose shoqatë e interesit të operatorëve ekonomikë. Personi i legjitimuar për të paraqitur këtë kërkesë janë vetëm OJF-të të cilat kanë për objekt të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. Sipas Nenit 50 të projektligjit, secili konsumator që vlerëson se është i cënuar nga sjellja për të cilën është kërkuar masa kolektive, ka të drejtën e ngritjes së një padie individuale për shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Kujtojmë se masa kolektive ka qëllim vetëm ndalimin ose parandalimin e sjelljes së paligjshme, por nuk disponon në lidhje me dëmshpërblimin e personave të dëmtuar. Megjithatë, në bazë të Nenit 52 të projektligjit, kur nëpërmjet një mase kolektive është konstatuar sjellja e paligjshme e një ndërmarrje, ky konstatim do të merret i mirëqenë nga gjykata që shqyrton padinë individuale për shqyrtimin e dëmeve. Në këtë logjikë, konstatimi i sjelljes së paligjshme konsiderohet “gjë e gjykuar”, nëse ka një masë kolektive të dhënë nga një gjykatë për këtë qëllim. Në bazë të Nenit 51, masa kolektive ka efekt për kontratat e lidhura me konsumatorët përpara masës kolektive si dhe për ato që do të lidhen pas marrjes së kësaj mase.

Në Seksionin III të këtij kreu parashikohen dispozita të posaçme në lidhje me masat kolektive që merren në mbrojtje kundër diskriminimit. Në Nenin 53 parashikohet e drejta për të kërkuar masa kolektive për këtë qëllim dhe në Nenin 54 parashikohet se personi i legjitimuar për të kërkuar këto masa kolektive janë vetëm OJF-të që kanë për objekt të veprimitarisë mbrojtjen kundër diskriminimit.

Në Kreun V të projektligjit është bërë një rregullim i mënyrës sesi do të mbulohen kostot e procedurave kolektive, shpërblimi i përfaqësueve dhe mekanizmat e financimit të procedurave nga palë të treta.

Në lidhje me përcaktimin e vlerës së padisë padisë, për efekt të pagimit të tarifës gjyqësore prej 1 % sipas Udhëzimit të Përbashkët nr. 33, datë 29.12.2014 për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë, neni 55 bën një rregullim lehtësues për grupin e dëmtuar. Kështu sipas paragrafit 1 të këtij neni, vlera e padisë për efekt të tarifës 1 % do të jetë e barabarte me 20 % të vlerës reale të padisë. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, në çdo rast vlera e padisë nuk do të llogaritet për një shumë më të lartë se 1 milion Lekë.

Bazur në Nenin 58 të projektligjit, kërkuesi ose paditësi kolektiv duhet t'i bëjë me dije gjykatës burimin e financimit të procedurave. Kjo bëhet për të shmangur ndikimin e paligjshëm të financuesve, të cilët mund të kenë interes në lidhje me rezultatin e një procedure kolektive për një dëm kolektiv të caktuar. Gjykata, në rastet kur konstaton se ka konflikt interesi në këtë drejtim, nuk e pranon për shqyrtim padinë kolektive. Në rastet kur financuesi është një subjekt privat, nuk lejohet ndikimi i këtij të fundit në çdo formë në veprimet procedurale të kërkuarit. Gjithashtu, një subjekt privat nuk mund të financojë një padie kolektive kundër një subjekti konkurent i tij, pasi haptazi gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Në rastet kur financimi është dhënë me një normë interesi, norma e interesit nuk mund të jetë më e lartë se norma e interesit e përlllogaritur sipas kuadrit ligjor në fuqi. Kjo dispozitë synon mbrojtjen e grupit të dëmtuar, por dhe të personit që ka shkaktuar dëmin kolektiv, nga pagimi i interesave të paarsyeshme të aplikuara nga financuesit.

Në bazë të Nenit 57 të projektligjit, pala gjyqëmbësore mbulon koston e gjykimit të një padie kolektive. Në këto kosto përfshihen shpërblimi i përfaqësuesit, kosto gjyqësore, shpërblimi i noterit si administrator i masës së dëmshpërblimit, si dhe shpenzime të tjera që i kanë paraprirë ngritjes së padisë kolektive.

Në Nenin 58 është parashikuar se shpërblimi i përfaqësuesit nuk do të jetë më i lartë se 15 % të kompensimit të përfituar. Ndërsa, kur shpenzimet e procedurës mbulohen nga përfaqësuesi, ky shpërblim mund të arrijë deri në 30 % të këtij kompensimi. Në mënyrë që të mos ketë abuzime në lidhje me përcaktimin e shpërblimit të përfaqësuesit, është menduar që ky shpërblim të përcaktohet në vendimin përfundimtar nga vetë gjykata, e cila do të bazohet në kompleksitetin e çështjes për të dhënë këtë vlerësim. Shpërblimi i përfaqësuesit nuk parapaguhet nga anëtarët e grupit. Së fundmi, në bazë të Nenit 59 të projektligjit, shpenzimet individuale të anëtarëve të grupit nuk rimbursohen. Këta të fundit as nuk i rimbursojnë shpenzimet e palës tjetër. Shpenzimet e palës së paditur, në rastin e një padie kolektive të pasuksesshme do të mbulohen me fondet e financimit të padisë kolektive.

Kreu VI dhe i fundit i projektligjit parashikon 3 dispozita kalimtare. Neni 60 detyron Ministrinë e Drejtësisë të miratojë një rregullore për mbajtjen e regjistrit publik të padive kolektive brenda 4 muajve nga miratimi i këtij projektligji, si dhe përcaktimin e procedurave që duhet të ndjekë noteri si administrator i shumës së kompensimit kolektiv. Neni 61 përcakton se ligji zbatohet dhe për dëmet kolektive të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi. Dispozita e fundit parashikon momentin e hyrjes në fuqi të projektligjit.